

PROF. DR. ROMEO GURAKUQI

Instituti i Historisë / Akademia e Shkencave e Shqipërisë
romeo_gurakuqi@hotmail.com; romeo.gurakuqi@asa.edu.al

**SHQIPËRIA NË BASHKËSINË PERANDORAKE TË ROMËS
1939-1943**

(Zgjidhja kushtetuese e raportit mes Shqipërisë dhe Italisë)

Abstrakt:

Artikulli studion historinë politike dhe institucionale të Shqipërisë gjatë pushtimit të saj nga Italia fashiste në periudhën 1939-1943. Autori shqyrton fenomene që zakonisht historiografia i klasifikon si fenomene pas-kapitullimi, të cilat kanë qenë të pranishme në të gjitha vendet e pushtuara nga ushtritë fashiste. Studimi shpjegon se si regjimi fashist në Shqipëri krijoi një strukturë shtetërore totalitare në aspektin e kontrollit të informacionit dhe të operacioneve të policisë sekrete, ndërsa në kontrollin më të gjerë të shoqërisë, ai mund të konsiderohet autoritar.

Për herë të parë në historiografinë shqiptare, autori propozon një ndarje ciklike të fazave nëpër të cilat kaloi pushtimi fashist italian i Shqipërisë. Një pjesë e rëndësishme e studimit i kushtohet analizës së rolit të Shqipërisë brenda Komunitetit Perandorak Romak, skemës perandorake të hapësirës së nënshtruar të jetesës, shkallës së autonomisë së dhënë autoriteteve shqiptare të qeverisë kukull brenda perandorisë, si dhe statusit të Mbretërisë së Shqipërisë në raport me kornizën më të gjerë perandorake, veçanërisht në krahasim me Mbretërinë e Italisë dhe Etiopinë.

Autori argumenton se zgjerimi i Perandorisë Fashiste Romake në Shqipëri ishte më shumë sesa një realitet institucional, politik, ekonomik apo kulturor; ai ishte një imagjinatë historike – një mit që nuk mundi t’u mbijetonte përmbysjeve të shpejta të Luftës së Dytë Botërore. Kjo përpjekje për të imponuar një regjim artificial në Shqipëri, si dhe përfshirja e gjerë e segmenteve të klasës së mesme dhe të lartë të vendit në këtë ndërmarrje imagjinare, çoi në një krizë lidërsipëri në këtë shtet të vogël ballkanik. Kjo krizë rezultoi katastrofike për një shtet që vetëm disa dekada më parë kishte dalë në skenën ndërkombëtare si një entitet i pavarur.

Fjalë kyç:

Italia fashiste, pushtimi i Shqipërisë, post-kapitullimi, Perandoria Fashiste Romake, bashkimi personal i kurorave, kolonializmi italian.

H y r j e

Më 7 prill të vitit 1939, Italia fashiste pushtoi ushtarakisht Shqipërinë, një shtet sovran, i qeverisur si mbretëri kushtetuese, në krye të së cilës ndodhej Mbreti i vetëshpallur Ahmet Zogu, i mbiquajtur Zog I. Shqipëria humbi pavarësinë kombëtare. Kemi të bëjmë me një zaptim klasik dhe një aneksim, i cili u përpoq të maskohej me një sërë veprimesh kushtetuese të imponuara mbi elitën e vendit që u përkul.

Sulmi dhe pushtimi i Shqipërisë më 7 prill 1939 u organizua në vetë të parë nga konti Ciano (Çiano) dhe rrethi i tij.¹ Shteti shqiptar u tregua i paaftë të rezistonte institucionalisht, siç do të bënin pak më vonë dy fqinjët e tij kundrejt shteteve fashiste. Për këtë ditë ishte menduar shumë pak, sidomos në aspektin e garantimit të sigurisë dhe integritetit të vendit. Madje, Italia në fakt i kishte “thyer me para” pothuajse të gjithë ata që kishin pushtet në dorë, në një mënyrë aq radikale, sa që pushtimi i Shqipërisë i kushtoi Benito Mussolini-t (Benito Musolini) vetëm 118 ushtarë të vranë, shumica prej tyre të "kositur" nën breshërinë e mitralozit të Mujo Ulqinakut.² Pushtimi fashist i Shqipërisë e futi vendin në një spirale trazirash që do të shkatërronin, në mënyrë të pakthyeshme, të ardhmen e një kombi të vogël dhe ende në proces përforcimi strukturor.

Cilat janë disa nga veçoritë e pushtimit italian të Shqipërisë? Arsyet janë të ndryshme. Nga njëra anë, aksioni mund të konsiderohet pjesërisht një përgjigje ndaj pushtimit gjerman të Çekosllovakisë, si për arsye prestigji, ashtu edhe si një parandalim i një përparimi të mundshëm gjerman në Ballkan. Arsyet e dytë lidhet edhe me prirjet ekspansioniste ekonomike: Italia e kishte konsideruar pozicionin e saj të ri në Shqipëri si një pikë mbështetjeje për përparime të mëtejshme në Ballkan. Duhet të

¹ R. J. B. Bosworth, *Mussolini's Italy. Life under the Dictatorship 1915-1945* (Penguin Books: 2006), 358.

² N. P. Stajka, B. D. Marku, Z. A. Martini, *Në sofër pa pastashutë e pa bistekë* (Assisi: 1961), 28.

kemi parasysh se politika italiane ndaj Shqipërisë ka qenë gjithmonë e paqëndrueshme në mbrojtjen e interesave shqiptarë, edhe kur vepronte brenda kuadrit të vet politik. Kjo politikë asnjëherë nuk ka qenë një politikë konsekuente, krejtësisht e dallueshme me politikën e dikurshme të perandorisë së dezintegruar dualiste deri në vitin 1918, apo me politikën amerikane në vitet 1919-1922. Ndërhyrja e saj në këtë moment synonte shfrytëzimin ekonomik të pasurive të Shqipërisë, si një mënyrë për të zbutur nevojat e saj të mëdha si një fuqi në rritje dhe në ekspansion, në një klimë të mbizotëruar nga fashizmi në Europë. Atasheu detar italian në Athinë, në tetor të vitit 1939, gjatë një bisede me kolegun e tij britanik në Athinë, shpjegoi arsyet që, sipas tij, justifikonin pushtimin italian të Shqipërisë. Këto arsye ishin: 1. nevoja italiane për të kontrolluar të dyja brigjet e rrugëdaljes së Adriatikut; 2. nevoja për shfrytëzimin e fushave naftëmbajtëse shqiptare; 3. perspektiva e një shtrirjeje strategjike në bregun lindor të Adriatikut deri në Korfuz; 4. nevoja për të mbrojtur Shqipërinë nga sulme të mundshme të Jugosllavisë dhe Greqisë – mbrojtje që nuk mund të realizohej pa praninë e një force pushtuese italiane.³ Goditja në Shqipëri, në fakt, ishte shumë më tepër sesa një ushtrim i *gunboat diplomacy* (politikë e jashtme që bazohet në kërcënimin ose përdorimin e armëve) në konkurrencë me gjermanët. Goditja ndaj shqiptarëve përbënte një operacion paraprak në programin që Musolini kishte ndërtuar për kënaqjen e ambicieve të tij. Kuptimi i këtij veprimi duhet të shqyrtohet në kuadrin e politikës së “peshës vendimtare” që Italia synonte të shfaqte dhe të vendoste në rajon. Ai agresion ishte vetëm hapi i parë i një politike me kuptim dhe objektiva afatgjatë. Pushtimi i Shqipërisë e bllokoi Jugosllavinë, i hapi Italisë së Musolinit rrugën antike të pushtimit romak në Lindje dhe kërcënoi Britaninë me humbjen e bazave të saj detare dhe mbizotërimin në Mesdheun Lindor. Në fund, pushtimi i Shqipërisë nga Italia e bindi Perëndimin demokratik se italianët tashmë ishin pozicionuar në mënyrë të qëndrueshme në kampin gjerman, dhe se vendet ballkanike ishin seriozisht të kërcënuara nga ky veprim.⁴ Kjo ndodhi megjithëse Shqipëria

³ *The National Archives*, London (më tej: TNA), Public Record Office (më tej: PRO), Foreign Office (më tej: FO), PRO FO 371/23715, R 9837/1335/90, Sir M. Palairt to Viscount Halifax, Athens 1 November 1939.

⁴ Macgregor Knox, *Mussolini Unleashed 1939-1941. Politics and Strategy in Fascist Italy's last War* (Cambridge University Press: 1982), 41.

nuk kishte kapacitetet e duhura për të përballuar një sipërmarrje kaq të jashtëzakonshme.

Pyetjet që ngrihen në kuadrin e këtij studimi janë: Cili ka qenë vendi i Shqipërisë në Komunitetin Perandorak Romak? A ishte pushtimi një zaptim dhe nënshtrim klasik, apo më tepër një sistem i protektoratit? Cila ka qenë shkalla e autonomisë së autoriteteve shqiptare të qeverisë kukull në perandorinë fashiste? A mund të ndërtohet një kronologji e cilësisë së pushtimit?

Ndërtimi institucional i Shqipërisë nën Italinë fashiste

Pushtimi ushtarak i Shqipërisë ndodhi gati tre vjet pas themelimit të Perandorisë Fashiste Romake (9 maj 1936). Për rrjedhojë, ky zhvillim përfaqësoonte një etapë të rëndësishme në projektimin e një Italie të re – një fuqi e aftë t'u diktonte agjendën e saj fuqive të tjera dhe, përmes ekspansionit, të shmangte dekadencën e vet si fuqi e madhe në rënie – një rënie që tashmë po perceptohej qartë nga fuqitë demokratike perëndimore.⁵ Menjëherë pas pushtimit, autoritetet e Romës nisën ndërtimin e fasadës së institucioneve shqiptare. I gjithë procesi i transformimit institucional u drejtua kryesisht nga italianët. Edhe shqiptarët, që ishin mbështetësit më të afërt të bashkimit me Italinë, u lanë mënjanë në këtë proces ideator ose u përdorën si marioneta aktoriale.

Më 12 prill 1939, “Asambleja Kushtetuese Shqiptare” aprovoi vendimet që iu paraqitën të gatshme: 1. regjimi që kishte ekzistuar deri atëherë në Shqipëri pushonte së vepruari; 2. Kushtetuta mbi të cilën kishte fillësën ky regjim abrogohej; 3. Asambleja emëronte një qeveri, e cila kishte pushtete të plota; 4. Asambleja shpallte se populli shqiptar, duke kujtuar dhe duke qenë mirënjohës për mbështetjen konstruktive që Duçja dhe Italia fashiste i kishin dhënë zhvillimit dhe përparimit të Shqipërisë, vendosi ta lidhte më ngushtësisht jetën dhe fatin e Shqipërisë me atë të Italisë, nëpërmjet vendosjes së lidhjeve të saj me një solidaritet edhe më të fortë mes dy vendeve. Marrëveshje të frymëzuara në kuadër të këtij solidariteti do të përfundoheshin në vijim ndërmjet Shqipërisë dhe Italisë; 5. “Asambleja Kushtetuese Nazionale”, duke interpretuar në mënyrë të njëzëshme vullnetin dhe duke synuar rizgjimimin kombëtar të

⁵ Alberto Basciani, *L'impero dei Balcani. L'occupazione italiana dell'Albania (1939-1943)* (Roma: Viella, 2022), 48.

popullit shqiptar, si dhe duke e konsideruar këtë si një akt solemn betimi për realizimin e këtij qëllimi, vendosi t'i ofronte Madhërisë së Tij, Viktor Emanueli III, Mbret i Italisë dhe Perandor i Etiopisë, kurorën e Shqipërisë në formën e një bashkimi personal, në të mirë të Madhërisë së Tij dhe të trashëgimtarëve të tij mbretërorë.⁶

Më 14 prill të vitit 1939, Këshilli i Ministrave të Italisë, nën kryesimin e Musolinit, aprovoi projektligjin për bashkimin personal ndërmjet Italisë dhe Shqipërisë. Neni i parë saktësonte se Mbreti i Italisë, duke pranuar Kurorën e Shqipërisë, merrte mbi vete – dhe për trashëgimtarët e tij – titullin e Mbretit të Italisë dhe Shqipërisë, si dhe të Perandorit të Etiopisë. Neni i dytë sqaronte më tej se, Mbreti i Italisë dhe i Shqipërisë, Perandor i Etiopisë, do të përfaqësohej në Shqipëri nga një Mëkëmbës i Përgjithshëm, me rezidencë në Tiranë.⁷ Me një projektligj të veçantë, Viktor Emanueli III emëroi Francesco Jacomoni-n (Francesko Jakomonin) si Mëkëmbës të Përgjithshëm të tij në Shqipëri. Pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme në Romë, me dekretin e datës 18 prill 1939, u themelua Nën-Sekretariati i Shtetit për Çështjet Shqiptare (SSAA) në krye të të cilit u emërua Zenone Benini,⁸ ish-zëvendës-president i Korporatës së Çelikut. SSAA ishte një trupë me 5 zyra, e krijuar mbi bazën e ligjit italian, që i përgjigjej drejtpërdrejt ministrit të Punëve të Jashtme të Italisë dhe, gjatë gjithë kohëzgjatjes së veprimtarisë së saj, nuk iu nënshtrua ligjeve shqiptare. SSAA kishte një strukturë paralele me strukturat institucionale që funksiononin sipas ligjit shqiptar, çka i jepte ministrit të Jashtëm italian pushtetin për të ndërhyrë në jetën politike të kombit shqiptar. Ndër rolet që luajti ky institucion ishin: përfaqësimi i Shqipërisë jashtë vendit, pas suprimimit të Ministrisë së Jashtme shqiptare në qershor 1939; politikëbërja në fushën e shëndetit publik dhe higjienës; mbikëqyrja e kulturës, propagandës dhe turizmit; si dhe trajtimi i çështjeve të natyrës ekonomike dhe financiare. Nën

⁶ *Archivio Storico Diplomatico, Ministero degli Affari Esteri, Roma* (më tej: *ASDMAE*), GA, busta 130, Decisione dell'Assemblea Nazionale Albanese dal 12 aprile 1939 sulla unione personale fra l'Italia e l'Albania. Po ashtu ky dokument gjendet edhe në: *TNA, PRO.FO. 371.23714, R 3075/1335/90, Composition of new Albanian Government*, Sir A. Ryan, Durazzo, 14 April 1939; *ASDMAE, GA, busta 90, Cronologia Albanese Cenni Storici*.

⁷ *ASDMAE, GA, busta 90, Cronologia Albanese Cenni Storici*.

⁸ *Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AQSH*), Fondi (më tej: F.) Mëkëmbësia e Përgjithshme, Viti (më tej: V.) 1939, Dosja (më tej: D.) 211. *La Conquista dell'Albania, da Capitano Marziale Feudale, Locri, 16 Marzo 1940*.

varësinë e kësaj zyre kanë qenë edhe shërbimi civil shqiptar, programet e punëve publike, zhvillimi i planeve urbane të qyteteve kryesore shqiptare, si dhe Zyra e Shtypit, Propagandës dhe Turizmit, e krijuar brenda Këshillit të Ministrave të Shqipërisë.⁹ Thënë ndryshe, SSAA funksiononte si një ministri fuqiplotë e Italisë, e cila kontrollonte në të gjitha aspektet jetësore shtetin e pushtuar.

Më 14 prill, një delegacion shqiptar, i përbërë nga 49 persona, u nis për në Romë. Ky delegacion, që mbërriti në kryeqytetin italian në mëngjesin e 15 prillit 1939, kishte ardhur për t'i ofruar Kurorën e Shqipërisë Mbretit Viktor Emanueli III. Lista e dërgatës sugjeron se nuk kishte pasur ndonjë konkurrencë të madhe mes shqiptarëve për të shkuar në Romë e për të marrë pjesë në poshtërimin final të vendit të tyre – një poshtërim që ata, në atë kohë frike, pasigurie dhe mundësish të rralla për të dalë në krye të punëve vendëse, nuk e “kuptonin” plotësisht. Krahas Kryeministrit dhe ministrit të Drejtësisë, në përbërje të dërgatës ndodheshin edhe dy anëtarë të familjes Vrioni, disa përfaqësues të fiseve nga Dibra, ish-sekretari i Përgjithshëm i Mbretit Zog, zoti Poppa, si dhe prelati Visarion Xhuvani. Nga Vlora, ndërkohë, morën pjesë vetëm dy delegatë. Delegatët u pritën me nderime të mëdha në Romë. Një nga shfaqjet më ironike të atyre ditëve ishte fakti se e gjithë vëmendja dhe lavdia e Shtëpisë së Savojës dhe e regjimit fashist, u përqendrua në marrjen e Kurorës Mbretërore të Skënderbeut – një veprim i konsideruar me rëndësi të madhe, por që u krye nga një trupë aspak përfaqësuese e kombit shqiptar, për shkak të moskrijimit të rrethanave që do të mundësonin një shprehje të lirë popullore të sovranitetit,¹⁰ në një Shqipëri tashmë të pushtuar ushtarakisht. Në mëngjesin e 16 prillit, në Romë, u krye edhe formalisht bashkimi i Kurorës së Shqipërisë me atë të Italisë, kur Viktor Emanueli III, Musolini dhe konti Çiano pritën një "delegacion shqiptar" të sajuar me ngut, i cili i ofroi Kurorën e Skënderbeut Mbretit të Italisë. Ky delegacion, sipas disa të dhënave, nuk ishte përfaqësues i klasave me ndikim në Shqipëri, me përjashtim të dy ose tre individëve.¹¹ Françesko Jakomoni, përfaqësuesi i deriatëhershëm

⁹ Giovanni Villari, “A Failed Experiment: The Exportation of Fascism to Albania”, at *Modern Italy*, vol. 12, no. 2 (June 2007): 162.

¹⁰ TNA, PRO. FO. 371/23714, R 3220/1335/90. Ryan to Halifax, Durazzo, 18 April 1939.

¹¹ *Foreign Relations of United States, Diplomatic Papers, 1939*, Volume II, (Gen. ed.) G. B. Noble, E.R. Perkins, (Editors) M. Axton, R. Churchill, F. C. Prescott, J. G. Reid

diplomatik italian në Shqipëri, u emërua Mëkëmbës i Mbretit të Italisë për Shqipërinë.¹²

Masat e marra nga italianët, në fakt, shkatërruan plotësisht brenda pak ditëve pavarësinë e Shqipërisë. Duhet theksuar se muajt e parë pas pushtimit u karakterizuan nga një atmosferë disfatizmi brenda elitës shqiptare, e cila pranoi të ndërmerre veprime unifikuese me Italinë fashiste. Aktet e tradhtisë së kësaj elite karakterizohen dhe ndahen në katër kategori kryesore: bashkëpunim politik, bashkëpunim ushtarak, bashkëpunim ekonomik dhe bashkëpunim në aspektin e shërbimit të administratës civile. Të gjitha këto akte mund të klasifikohen kryesisht si një lloj kolaboracionizmi i gërshetuar me akomodim, në rrethanat e një nënshtrimi pa rrugë shpëtimi. Fenomene të tilla nuk janë vetëm shqiptare, por u ndeshën përgjithësisht në të gjitha vendet ku ushtritë e vendeve fashiste vendosën këmbën dhe, në historiografi, konsiderohen si **fenomene të post-kapitullimit**.¹³ Por në rastin shqiptar të bashkëpunimit, vërehet një vijimësi e një mentaliteti kulturor të trashëguar nga epoka para pavarësisë, si dhe një sens justifikimi dyfaqësor dhe fatalist, që karakterizonte individët që firmosën aktet dhe u vunë nën shërbim: përkulje dhe bindje në planin e jashtëm, dhe një përpjekje për justifikim në planin e brendshëm. Kjo skenë vazhdoi gjatë në një Shqipëri me aq shumë probleme njësueshmërie formative kombëtare dhe me një patriotizëm që shpesh u nënshtrohej interesave personalë.

Pushteti fashist ndërtoi në Shqipëri një strukturë shtetërore që, në planin e kontrollit të informacionit dhe të policisë së fshehtë ishte totalitare, ndërsa në raport me kontrollin e shoqërisë në tërësi, mund ta konsiderojmë si autoritare.

etc. (Washington: United States Government Printing Office, 1956), 765.75/508. The Minister in Albania (Grant) to the Secretary of State, Tirana, April 17, 1939.

¹² TNA, PRO. FO. 371/23714, R 3180/1335/90. The Earl of Perth, Rome, April 22. 1939.

¹³ Henry L. Mason, *The purge of Dutch Quislings, Emergency Justice in the Netherlands* (The Hague: Martinus Nijhoff, 1952), 4.

Kushtetuta e re

Legalizimi i regjimit të ri dhe vendosja e tij nën një kuadër kushtetues simetrik dhe të nënrenditur njëkohësisht me Italinë ka qenë hapi i radhës së komanduesve të Shqipërisë në Romë.

Më 3 qershor 1939, Mbreti Viktor Emanueli III priti një delegacion shqiptar, i cili kishte ardhur për t'i paraqitur kërkesën për trupëzimin e forcave të armatosura shqiptare në ushtrinë italiane. Pas kërkesës,¹⁴ Mbreti Viktor Emanueli III u komunikoi ministrave shqiptarë Kushtetutën e re të Shqipërisë, përgatitur nga juristët italianë, thjesht për t'u aprovuar. Kushtetuta synonte të përcaktonte strukturën e re institucionale të Mbretërisë së Shqipërisë; ajo përbëhej nga 54 nene të ndara në 7 krerë. Sipas asaj që u komunikua menjëherë, forma e qeverisjes së Shqipërisë do të ishte një monarki kushtetuese e trashëguar. Flamuri do të ishte i kuq me shqiponjën dykrenore, por në qendër do t'i shtohej edhe emblema e fashizmit. Pushteti legjislativ do të ushtrohej nga Mbreti dhe nga Këshilli i Lartë Koorporativ fashist. Të drejtat dhe detyrat e shtetasve do të ishin të ngjashme me ato të përcaktuara edhe në kushtetutën italiane. Përmbajtja e kushtetutës nuk përmendte fare marrëdhëniet me jashtë, çka përbënte një sinjal të qartë se Ministria e Jashtme e Shqipërisë do të shkrihej me atë të Italisë. Kushtetuta u firmos më 3 qershor 1939 nga Viktor Emanueli III, Shefqet Verlaci, Teufik Mborja, Xhafer Ypi, Maliq Bushati, Fejzi Alizoti, Anton Beça dhe Ernest Koliqi, dhe hyri në fuqi më 4 qershor 1939.¹⁵ Ky vendim shënoi hapin themelor njëjtësues të projektit perandorak fashist në Shqipëri. Nga pikëpamja formale dhe ligjore, bashkimi i Italisë me Shqipërinë lidhej me të drejtën ndërkombëtare, pasi, në dukje, përfaqësonte një marrëveshje ndërmjet dy parlamenteve sovrane. Formalisht, Shqipëria ruante territorin, popullin dhe sovranitetin – kushtet themelore për ruajtjen e dallueshmërisë shtetërore. Megjithatë, në pikëpamje thelbësore, Mbretëria e Shqipërisë hynte në këtë bashkim si entitet i nënrenditur, me karakteristikat e një kolonie. E gjithë korniza institucionale, në termat e strukturës dhe thelbit, i kundërvihej barazisë së supozuar shtetërore

¹⁴ TNA, PRO. FO. 371/23715, R 4759/1335/90. Sir P. Lorisio to Halifax, Rome, June 6, 1939.

¹⁵ AQSH, F. Mëkëmbësia e Përgjithshme, V. 1939, D. 20. Statuto Fondamentale del Regno di Albania. Statuti Themeltar i Mbretnisë së Shqipërisë.

ndërmjet kombit shqiptar dhe atij italian, shkruan studiuesi Giovanni Villari.¹⁶

Ajo që ndodhi në fakt, në harkun kohor nga 12 prilli 1939 deri më 3 qershor 1939, në të vërtetë, ishte kapitullimi i një grushti shqiptarësh të përzgjedhur nga autoritetet italiane për të kryesuar qeverinë e re pas pushtimit italian, me praninë dhe bashkëpunimin e plotë të Mbretit Viktor Emanueli III, i cili, po ashtu, mbartte përgjegjësi ndaj fatit të pushtimit të Shqipërisë, pavarësisht rolit formalizues të monarkut. Të gjitha këto masa shënuan konsolidimin e mbizotërimit politik, ekonomik dhe kulturor italian në Shqipëri, si dhe eliminuan pavarësinë edhe në pikëpamje kushtetuese. Emërtimet/konceptet "pavarësi" dhe "integritet" u zhdukën nga përmbajtja e kushtetutës. Mbi të gjitha, mënyra se si kushtetuta e re iu imponua shqiptarëve – pa asnjë lloj votimi apo konsultimi popullor, tregonte për gjendjen e mjerueshme të vendit në pikëpamje të shtetësisë, të lirive dhe mundësive për vetëvendosje. Vula vërtetuese e këtij nënshtrimi ishte mënyra se si Shqipëria, përmes disa politikanëve të nënshtruar, ia dorëzoi Italisë edhe kontrollin mbi marrëdhëniet e saj ndërkombëtare.

Ciklet nëpër të cilat kaloi okupacioni

Periudha e pushtimit fashist italian të Shqipërisë, sipas këndvështrimit tim, mund të ndahet në disa faza përbërëse. Këtë ndarje e kam bazuar në linjat politike dhe institucionale të ndjekura, ngjarjet ushtarake dhe qeverisëse, si dhe në diagramën që ndoqi pushteti fashist në Shqipëri gjatë viteve 1939-1943. *Faza e parë është ajo e përgatitjes së modelit të integritit të Shqipërisë nën kornizën e Perandorisë Fashiste Romake.* Ajo përfshin periudhën prill-qershor 1939. Gjatë kësaj kohe, hierarkia fashiste ruajti një fasadë formale të pavarësisë së Shqipërisë dhe krijoi një situatë pritjeje që shërbeu për të përgatitur nënshtrimin e plotë institucional të vendit. *Faza e dytë fillon me hyrjen në fuqi të kushtetutës së re fashiste në Shqipëri, më 4 datë qershor 1939 dhe vazhdon deri më 28 tetor të vitit 1940,* kur Italia fashiste, përmes territorit të Shqipërisë së Jugut, sulmoi Mbretërinë e Greqisë, një shtet sovran. Musolini dhe konti Çiano, përmes një sërë masash reformuese, institucionale dhe ekonomike, arritën të krijonin edhe në Shqipëri një model shtetëror të ngjashëm me

¹⁶ Villari, *A Failed Experiment*, 161.

atë të Italisë fashiste. Megjithatë, është e kuptueshme se ky model, në një popull si ai i Shqipërisë, mbeti kryesisht në formën e një ekspozimi propagandistik dhe institucionalisht të paqëndrueshëm, pa arritur të depërtonte në vetëdijen e përgjithshme të masës së banorëve. Përthithja e ideologjisë ishte formale, shpesh servile dhe përfituese, por në asnjë rast bindëse. Gjatë kësaj faze mund të thuhet se u përmyll procesi i modelimit dhe fashistizimit të institucioneve shtetërore shqiptare brenda perandorisë disi imagjinare të Romës mbi bazën e modelit italian. Njëkohësisht u ngritën edhe strukturat për shfrytëzimin e rezervave minerare të vendit, në funksion të qëllimeve imperialiste dhe kolonialiste të Italisë. Brenda pesë muajve të parë pas pushtimit, shteti shqiptar që kishte ekzistuar para 7 prillit 1939 u shua plotësisht. E ashtuquajtura “barazi juridike” mes dy vendeve partnere ishte e privuar nga çdo karakter praktik dhe Shqipëria iu nënshtrua tërësisht hegjemonisë italiane. Nëpërmjet kontrollit të levave të politikës ndërkombëtare, Italia kontrollonte të gjithë politikën e jashtme të Shqipërisë. Përmes tagrave të ngarkuara Mëkëmbësisë, Italia drejtonte politikën e brendshme, administrative dhe legjislativë të shtetit shqiptar. Përmes veprimtarisë së Partisë Fashiste Shqiptare (PFSH) Italia kontrollonte shqiptarët dhe shkallën e besnikërisë së tyre politike. Kështu, me këtë *anchluss* të ri, Shqipëria u shndërrua në një shtet kukull të Boshtit Qendror, në modelin e një "aleati" të vogël në rrugën e shteteve fashiste për të depërtuar drejt Lindjes në vitet 1941-1943.¹⁷ Gjatë fazës së dytë, pas gati një viti të një procesi fashistizues dhe shfrytëzimi ekonomik, klika fashiste e Romës u përgatit për një ekspansion të mëtejshëm në Mesdhe dhe Ballkan. Kështu, gjatë pranverës së vitit 1940, sjellja e autoriteteve pushtuese në Shqipëri ishte në funksion të përgatitjes për ballafaqim me Britaninë e Madhe në detin Mesdhe dhe me Greqinë në jug të Ballkanit. Me fillimin e përgatitjeve për Luftën Italo-Greke nga territori shqiptar, përfundoi periudha e instalimit institucional të fashizmit në Shqipëri, dhe bashkë me të edhe koha e qetësisë relative dhe e prosperitetit të përkohshëm ekonomik që pushtuesit kishin sjellë në këtë pjesë të perandorisë së tyre të sajuar. *Faza e tretë është ajo e Luftës Italo-Greke, e cila zgjati nga 28 tetori 1940 deri në prill të vitit 1941.* Në këtë kohë, marrëzia e establishmentit romak në Shqipëri dhe në Ballkan do të tronditet dhe do të ndalet dramatikisht, pavarësisht se rezultati përfundimtar i prillit 1941

¹⁷ Basciani, *L'impero dei Balcani*, 64.

krijoi përshtypjen e një fitoreje dhe të një zgjerimi të okupacionit dhe zotërimeve italiane në Ballkan. Në fakt, ky zgjerim u realizua falë makinerisë hitleriane të luftës, dhe jo për shkak të fuqisë së ushtrisë italiane, e cila ishte e papërgatitur për këtë aksion dhe shfaqti gjithë pamundësinë e saj strukturore për të qenë një armatë vërtet imponuese në Mesdhe. Kjo fazë e tretë përfundon më 23 prill të vitit 1941, me bashkimin e Shqipërisë së Vjetër dhe “Tokave të Lirueve” në një shtet të vetëm shqiptar, me shtrirjen më të madhe gjeografike deri atëherë në historinë moderne. Kështu, 23 prilli i vitit 1941, konsiderohet konvencionalisht si *Dita e Themelimit të Shqipërisë së Bashkuar*. Në këtë ditë, ne kemi pikasur dhe vendosur startin e *fazës së katërt të pushtimit italian të “Shqipërisë së Madhe”, tashmë nën sundimin e Italisë*, e cila, nga pikëpamja e politikës së brendshme, karakterizohet nga ezaurimi gradual i qeverisë së Shefqet Verlacit dhe nga përpjekjet për ristabilizimin e autoritetit fashist italian në vend, përmes Kryeministrit Mustafa Merlika. Kjo fazë zgjat deri në janar të vitit 1943, me rënien e qeverisë Merlika dhe fillimin e krizave të njëpasnjëshme qeveritare. Ajo karakterizohet nga një përpjekje për unifikim në aspektin administrativo-institucional të shtetit kombëtar; fillimisht, nga një butësi relative ndaj komunistëve; nga goditje të synuara ndaj veprimtarisë kryengritëse; si dhe nga një frazeologji gjithnjë më e theksuar fashiste, e ndërthurur me një ligjërim të kultivuar me tone patriotike. *Faza e pestë fillon në janar 1943 dhe përmbillet me kapitullimin e Italisë më 8 shtator të po atij viti*. Gjatë kësaj faze të fundit, pushtimi karakterizohet nga kriza ciklike dhe të pandërprera politike dhe qeverisëse, si dhe nga rritja e pandalshme e lëvizjes së rezistencës nacionalçlirimtare dhe nacionaliste. Po ashtu, në mesin e kësaj periudhe vërehet një përpjekje për korrigjim politikash dhe për një autonomi më të madhe shtetërore të entitetit shqiptar brenda “Komunitetit Perandorak”. Kjo përpjekje shoqërohet edhe me ndërrimin e “kavalierëve” të politikës italiane në Shqipëri (rënia e Jakomonit dhe ardhja në krye e Mëkëmbësisë së Alberto Parianit), defashistizimin formal të strukturave shtetërore, ushtarake, policore, si dhe krijimin e policisë dhe ushtrisë shtetërore.

Rasti i pushtimit dhe bashkimit të Shqipërisë me Italinë përbën një model krejtësisht të veçantë, i cili, megjithatë, nuk u zbatua me konsekuencë. Gjatë katër viteve të pushtimit, kjo skemë italiane e nënshtrimit të Shqipërisë dhe e raporteve ndërshtetërore pati edhe tërheqje nga projekti fillestar konstitucional. Një nga karakteristikat

kryesore të këtij modeli ishte zgjedhja e formës së bashkimit personal, sipas së cilës Viktor Emanueli III u bë edhe sovran i Shqipërisë. Duhet theksuar se kjo vendimmarrje e minutës së fundit ishte një devijim nga marrëveshja që liderët shqiptarë të kolaboracionit, të përfshirë në rrëzimin e Zogut, kishin bërë me italianët. Sipas Ernest Koliqit, pala italiane kishte bërë një marrëveshje paraprake me një pjesë të opozitës së Zogut. Kjo marrëveshje parashikonte krijimin e një *commonwealth*-i dhe zëvendësimin e Mbretit Zog me një princ nga Shtëpia e Savojës. *Megjithatë, marrëveshja fillestare ndryshoi* me formën e bashkimit të kurorave mbretërore nën të njëjtën perandori, për të cilën disa nga figurat kryesore, ndër ta edhe Ernest Koliqi, nuk ishin marrë vesh.¹⁸ Studiuesit ende nuk e kanë të qartë arsyen e këtij ndryshimi të vendimmarrjes fillestare: nëse ai ishte produkt i kompromisit autoritar të përfunduar me Monarkinë dhe elitat tradicionale, nga të cilat Musolini nuk arriti të shkëputej, apo ishte rezultat i një plani makiavelian për t'u shkëputur nga Monarkia në fund të konfliktit – një përmbysje e përllogaritur që do të kishte pasoja edhe në territoret e bashkësisë perandorake, përfshirë edhe Shqipërinë? Apo ndoshta bashkimi personal i përgjigjej një ideje tranzitore të kontrollit të protektorateve italiane, zbatuar në mungesë të një plani më origjinal dhe me vulë të qartë fashiste? Këto janë pyetjet që ngre studiuesi Davide Rodogno.¹⁹ Në këndvështrimin tonë, bashkimi personal ishte rezultat i një kompromisi midis ambicieve fashiste për zbatimin e skemës perandorake të hapësirës vitale, kërkesave të elitës nacionaliste shqiptare të komprometuar me fashizmin, si dhe zgjidhjeve të kushtëzuara nga rrethanat konkrete të Shqipërisë dhe zhvillimeve në terren. Shqipëria u pushtua në vitin 1939, para se të niste Lufta e Dytë Botërore, në një kohë kur ende nuk kishin nisur pushtimet tipike unifikuese brenda vendeve me ambicie ekspansioniste të tipit fashist. Kësisoj, në rastin e Shqipërisë, Musolini, vërtet nuk pranoi planin e kolaboracionistëve shqiptarë proitalianë për të eliminuar Mbretin Zog dhe për ta zëvendësuar me një anëtar të familjes mbretërore të Savojës, por nuk zgjodhi as skemën teorike që do ta aplikonte më vonë, për njëjtësimin e vendit të okupuar në perandori, si një shtojcë krejtësisht formale të Romës. Roma vendosi të ruante formalisht disa institucione të

¹⁸ Letër e Ernest Koliqit, 18.07.1952, drejtuar Karl Gurakuqit, "Letërkëmbim në Mërgim", dosja 1, arkivi privat i autorit.

¹⁹ Davide Rodogno, *Il Nuovo Ordine Mediterraneo. Le politiche di occupazione dell'Italia fascista in Europa (1940-1943)* (Torino: Bollati Boringhieri, 2014), 85.

indipendencës: lejoi një qeveri të kontrolluar, krijoi Partinë Fashiste Shqiptare – e drejtuar nga vetë Musolini; sajoi një flamur shqiptar i cili ruante disa simbole të independencës, por të fashistizuara, flamur që më pas u detyrua sërish ta ndryshonte. Po ashtu, ngriti një përfaqësi politike ku përfshiu të gjithë elitën e vendit, hodhi para korruptive për shumëkënd që i kërkoi mbështetje financiare private, nga njerëzit e zakonshëm të Shqipërisë deri te kolaboracionistë të mirëfilltë. Ky rast është i ndryshëm nga implementimet e mëvonshme të vendeve fashiste në Europë, si dhe nga *Skema Perandorake e Hapësirës Jetësore të Nënshtruar*, faktikisht dhe formalisht. Siç duket, Musolini vendosi të mos e aneksonte Shqipërinë formalisht, duke ruajtur një mirazh pavarësie që në realitet nuk ekzistonte, ndërkohë që i gjithë kontrolli ishte në Romë dhe ushtrohej përmes Mëkëmbësit të Mbretit, Jakomoni. E gjithë kjo do t'i shërbente atij për të propaganduar idenë e komunitetit perandorak roman dhe misionin qytetëruar e çlirimtar të fashizmit kundrejt Mbretit, i cilësuar me përçmim si “inJORant” dhe “obskurantist”. Pushtimi i Shqipërisë ishte gjithashtu një shfaqje e zbatimit të një doktrine politike që bazohej jo vetëm në synime sociale, por edhe në disa parime ekonomike që Perandoria e Romës kishte aplikuar në vendet brenda sferës së saj perandorake. Fashizmi italian, siç duket, edhe për këto arsye, mbështeti nacionalizmin shqiptar dhe synimet e tij për bashkimin e trojeve kombëtare në një shtet të vetëm. Në këtë mënyrë, Shqipëria përbënte precedentin për sa i përket parimit të etnicitetit unik të territorit (“një territor për një racë dhe një komb”).²⁰ I tillë ishte edhe fjalori që përdorte makineria ideologjike kolonialiste italiane në Shqipëri dhe për Shqipërinë e robëruar nga klika fashiste.

Shqipëria në Bashkësinë Perandorake të Romës. Procesi i rindërtimit dhe i italianizimit të Shqipërisë (1939-1943)

Vlerësimi ynë mbi pozitën e Shqipërisë në të ashtuquajturën Bashkësi Perandorake Romake do të zhvillohet në dy plane: *së pari*, do të analizojmë mënyrën se si “aristokracia” italiane e “qytetërimit të ri” zhvilloi misionin e saj të konsideruar civilizues në Shqipëri, si dhe në çfarë mase ajo ishte e ndërgjegjshme për këtë mision dhe për të ashtuquajturin superioritet racial, moral e shpirtëror të italianëve; *së dyti*,

²⁰ *Po aty*, 87.

do të përpiqemi të vlerësojmë si është përjetuar ky mision i italianëve në mjedisin shqiptar, duke filluar nga klasa e bashkëpunëtorëve deri te njerëzit e thjeshtë. Në përmbyllje do të nxjerrim disa konkluzione nga analiza e këtyre dy planeve kryesore dhe e impaktit që bashkësia perandorake, kolonizimi dhe italianizimi patën mbi Shqipërinë e dorëzuar ndaj synimeve fashiste.

Synimet e vërteta të Musolinit në Shqipëri nuk ishin aspak qytetëruese, por tipike imperialiste, kolonialiste dhe shfrytëzuese. Shqipëria ishte paracaktuar më herët të bëhej i pari satelit në orbitën e perandorive të reja, të konceptuara sipas një plani të ideuar më parë nga Hitleri dhe më pas të përkrahur nga Musolini, bazuar në teorinë gjermane që popujt superiorë kanë të drejtë të vendosin nën zgjedhë shtetet e vogla mbi bazën e një rendi të ri.²¹ Pra, pjesa më e madhe e politikës italiane ishte, në mënyrë të natyrshme, një reminishencë e këndvështrimit nazist mbi racën dhe perandorinë. Por, midis projektit perandorak të Hitlerit dhe atij të Musolinit ekzistonin dy dallime kryesore: *së pari*, Hitleri e mori shumë më seriozisht përjashtimin racial sesa Musolini; *së dyti*, fashizmi italian, ashtu si imperializmi klasik, e pa barrën e vet qytetëruese të shtrirë kryesisht jashtë Europës, ndërkohë që nacional-socialistët gjermanë nuk e panë kështu.²² Megjithatë, paragjykimet racore të të dyja fuqive të Boshtit nuk patën pothuajse asnjë valencë të ngjashme në rastin e trajtimit të shqiptarëve gjatë dy periudhave të pushtimit. Nga ana tjetër, strukturat politike dhe shoqërore që ata ndërtuan në trevat shqiptare – veçanërisht gjatë pushtimit italian – ngjanin tipikisht me ato që u imponoheshin popujve të nënrenditur në robëri dhe përcëim kolonialist.

Shqipëria e pushtuar u rindërtua sipas “Projektit Perandorak Fashist”. Formalisht, brenda kuadrit të perandorisë fashiste, Italia dhe Shqipëria vendoseshin në pozicione paralele dhe të barabarta. Rregullimi politik, institucional dhe administrativ i Mbretërisë së Re të Shqipërisë u përputh me vlerat e regjimit fashist të ideuar në Romë, ndërsa vetë Shqipëria projektohej si kryeurë italiane në hapësirën danubiano-ballkanike, në kundërpozicion si ndaj Rajhut gjermanik, ashtu edhe ndaj ndikimit tradicional që kishte pasur deri atëherë Franca. Kjo nënkuptonte

²¹ Leone G. B. Nigris, Delegato Apostolico, *Cenni sulle vicende dell’Albania dal 1938 al 1944*, 01.01.1945, 10. Archivio della Segreteria, Vaticano, Affari Strategici, Albania 57, Prot. 2567/45, Delegazione Apostolica in Albania.

²² Mark Mazower, *Dark Continent. Europe’s Twentieth Century* (Penguin books: 1999), 73.

këputje të varësive të së kaluarës, modernizim, asimilim italianizues, fashistizim të plotë dhe pastrim nga "toksinat" tipike të popullive të prapambetura ballkanike.²³ Regjimi fashist italian në Shqipëri, pas kalimit të javëve të para, kultivoi gradualisht idealin perandorak, të cilin e mbante "brenda kokës së tij" vetëm diktatori romak, si dhe rrethi i njerëzve të regjimit. Objektivi i Musolinit ka qenë ai i-mirënjohuri: organizimi i hapësirës së pushtuar shqiptare si pjesë e hapësirës jetësore italiane, duke i imponuar popullit shqiptar të drejtën dhe qytetërimin fashist, ndërsa e paraqiste veten si "çlirimtar i popullit shqiptar nga Mbreti obskurantist". Më pas, ky vend do të duhej të shërbente si pedanë nga e cila Italia fashiste do të ndërmerre agresione të mëtejshme imperialiste në rajonin ballkanik. Goditja e parë e radhës që synonte Musolini ishte Greqia, me pretekstin e çlirimit të Çamërisë në favor të Shqipërisë. Qasja strukturaliste e ideologjisë fashiste që frymëzoi edhe pushtimin e Shqipërisë ka qenë e prirë nga ideja se

"historia vazhdon drejt sistemimit të shoqërisë njerëzore në kolektivitete të mëdha, që jetojnë gjeopolitikisht në të ashtuquajturat hapësira të mëdha".²⁴

Teoricienët fashistë besonin se bota përjetonte një lëvizje të dukshme kaotike mes popujve, të cilët ishin përherë në ndryshim dhe në fërkime me njëri-tjetrin. E gjithë kjo lëvizje kaotike përfaqësonte, në të vërtetë, një rrjedhë të lehtë dhe të qëndrueshme të një evolucioni të qartë, i cili synonte të çonte entitetet etnike të konsideruara "më të larta" – në krahasim me racat dhe qytetërimet e tjera – drejt një zmadhimi të pandërprerë dhe gjithnjë në rritje. Kështu, Roma fashiste do të organizonte një kompleks kombesh, secila me autonominë e vet në gjuhë dhe kulturë, të cilat do të vërtiteshin rreth Italisë. Kjo e fundit do të kishte mbizotërim absolut mbi këto kombe të varura, me detyrimin për t'u garantuar atyre ruajtjen dhe zhvillimin e brendshëm, në kuptimin romak të fjalës. Sipas ideologjisë fashiste, qëllimi i shtrirjes ishte qytetërimi i popujve të pushtuar, eksportimi i revolucionit në vendet e pushtuara dhe imponimi i kriterëve morale, racore, të drejtave, virtyteve, fuqisë dhe lirisë nën kornizën musoliniane. Shqipëria u përcaktua si objektivi kryesor i Musolinit, siç tregojnë edhe fjalimet e tij të mbajtura para

²³ Basciani, *L'impero dei Balcani*, 49.

²⁴ Rodogno, *Il Nuovo Ordine*, 71-72, 73.

Këshillit të Madh fashist më 30 nëntor 1938 dhe 5 shkurt 1939, ku ajo dallohej qartë nga objektivat e tij të tjerë me afat të mesëm dhe të largët.²⁵

Perandoria fashiste nuk u konceptua si një federatë shtetesh, pasi e drejta për rregullimin e jetës së kombeve të asociuara, pra edhe ajo e kombit shqiptar, do të përcaktohej vetëm në Romë. Shteti dhe entiteti autonom shqiptar, i zhveshur nga sovraniteti real, do të shndërrohej në fakt në një komb shërbenjës ndaj kombit udhëheqës italian. Kjo ka qenë e gjithë filozofia e ndërtimit institucional të Shqipërisë nën Italinë fashiste, sipas vlerësimit të historianit Davide Rodogno.²⁶ Ndërsa Leone Nigris shkruante se flitej e shkruhej për një rend të ri, themeli i të cilit ishte ideja se shtetet e vogla duhej të ishin satelite të shteteve të mëdha, megjithatë raportet mes tyre nuk u saktësuan asnjëherë juridikisht. Në thelb bëhej fjalë për një të ashtuquajtur “e drejtë pozitive në përdorim”, që në fakt ishte një dhunim i së drejtës natyrore. Për më tepër, ishte mohuar e drejta natyrore e shqiptarëve dhe ishte shpallur se vullneti i një njeriu bën ligjin dhe forca është burim i së drejtës.²⁷

Një konfederatë vullnetare e shteteve të vogla në ndikimin e një shteti të madh nuk ishte përkundër së drejtës natyrore: një gjë e tillë ndodh, si rregull, për shkak të zhvillimit të një procesi normal dhe natyror të bashkimit të komuniteteve që pranojnë të shoqërizohen vullnetarisht në një shtet më të madh. Por ky nuk ishte rasti i bashkimit të dhunshëm të Shqipërisë me Italinë dhe në këto zhvillime dramatike për vendin, nuk bëhej fjalë për një rend të ri natyror, por për një bashkim të imponuar mbi bazën e dhunës së shkaktuar nga vullneti i një lideri suprem dhe kastës fashiste që e shoqëronte në këtë sipërmarrje aventurore.

Nga studimet e autorëve të regjimit fashist, të realizuara para dhe gjatë pushtimit, që merren me “argumentimin” e përfshirjes së Shqipërisë në Bashkësinë Perandorake Romake, dëshiroj të veçoj juristin Gaspare Ambrosini-n. Ai është autor i veprës “Shqipëria në komunitetin perandorak të Romës”,²⁸ ku paraqet një analizë të hollësishme juridiko-kushtetuese dhe një përpjekje për të justifikuar kornizën pushtuese mbi të cilën u vendos Mbretëria e Shqipërisë. Sipas Ambrosini-t, bashkimi mes

²⁵ *Po aty*, 71-72, 73.

²⁶ *Po aty*.

²⁷ Nigris, *Cenni sulle vicende dell'Albania*, 14-15.

²⁸ Gaspare Ambrosini, *L'Albania nella comunità imperiale di Roma*, Quaderni dell'Institut Nazionale di Cultura Fascista, Serie Decima (Roma: N. V -1940), XVIII E. F.

Italisë dhe Shqipërisë ishte një bashkim mbretëror, pasi, përveç vetë personit të kryetarit të shtetit dhe regjimit të njëjtë – të dyja shtetet kishin, në bazë të marrëveshjeve të posaçme mes tyre (të imponuara, do të shtoja unë), edhe shërbime të përbashkëta të njësuara për aktivitetet shtetërore me rëndësi themelore: përfaqësitë diplomatike dhe konsullore (Konventa e 3 qershorit 1939), doganat (Marrëveshjet e 20 prillit dhe 28 majit 1939), Forcat e Armatosura (Vendimi i Këshillit të Ministrave të Shqipërisë i 26 majit 1939, ligji italian i 13 korrikut dhe Dekreti Mëkëmbësor i 11 dhjetorit 1939). Këtij cilësimi si “Bashkim Real-Mbretëror”, sipas tij, nuk i binte ndesh as vendimi i datës 12 prill 1939, i pasqyruar në Kushtetutën e Shqipërisë, neni 4, ku thuhej se:

“Asambleja vendosi me ia ofru Kurorën e Shqipërisë, Viktor Emanuelit III, Mbret i Italisë dhe Perandor i Etiopisë, pasardhësve të tij, në formën e një Bashkimi Personal.”

Dhe kjo, jo vetëm sepse sistemi mund të modifikohej në vijim me marrëveshjet që u kryen më pas, por edhe sepse i njëjti nocion (neni 3) i kushtetutës bënte fjalë për raporte më të ngushta që do të vendoseshin me Italinë.

Për të përforcuar tezën e tij, Ambrosini shton se,

“këtu bëhet fjalë për një asociacion më të hollësishëm të jetës dhe fateve të të dy shteteve, të vendosjes së varësive të një solidariteti gjithnjë e më të ngushtë: parashikohet nënshkrimi i marrëveshjeve të posaçme; bëhet fjalë për bashkësi qëllimesh, aktivitetesh dhe shërbimesh publike, që doktrina njëzëri i konsideron si elemente karakteristike të Bashkimit Real dhe jo Bashkimit Personal”.²⁹

Duke avancuar edhe më tej arsyetimin, Ambrosini nuk ndalet në fshehjen e qëllimeve të establishmentit romak, por saktëson se,

“Komuniteti Perandorak i Romës përfaqëson një tip të ri të organizimit të popujve, në të cilin, përmes Duçes, i shtohet nivelit paraekzistues. Bëhet fjalë për një kompleks të ri të organizmit politik, një **corpus misticum** të ri, të formuar prej pjesëve të ndryshme, të cilat, edhe pse konkurrojnë të gjitha për të arritur të njëjtat qëllime të përbashkëta, edhe pse secila nxjerr avantazhet e veta, nuk ndodhen në të njëjtin plan: vijnë të parat, Italia dhe Shqipëria; ndjekin, në një pozicion të spikatur, por jo të barabartë me atë italo-shqiptar, Libia dhe zotërimet e Egjeut; qëndron në

²⁹ *Po aty*, 62.

fund, në një pozicion tjetër, Afrika Lindore Italiane. Asnjë prej anëve të këtij Komuniteti Perandorak nuk ka funksionin e një instrumenti të thjeshtë, aq më pak një funksion të nënvendosur shfrytëzimi; të gjitha këto anë marrin pjesë në një qëllim të përbashkët dhe përftojnë avantazhe të barabarta, në mënyrë konforme me traditën e Romës”.³⁰

Në ndryshim nga vendet e tjera të përfshira në Perandorinë Romake Fashiste, Ambrosini shkruante se Shqipëria ishte thirrur për të bërë pjesë në Komunitetin Perandorak të Romës si një entitet shtetëror autonom dhe i pavarur, i bashkuar ndaj këtij entiteti.³¹ Por, a ishte vërtet ky statusi real i Shqipërisë?

Në fakt, jemi në rrethanat e një mashtrimi juridik për të justifikuar të ashtuquajturin “bashkim personal”. Në realitet, Shqipëria ndaloi së qeni subjekt i pavarur i së drejtës ndërkombëtare, ndërsa e gjithë procedura e ndjekur shkonte përkundër vullnetit popullor dhe ishte e shoqëruar me veprime *legjislative me karakter të falsifikuar* (Asamble Kushtetuese e imponuar, vota të fabrikuara).

Në qasjen e ndjekur, këtë e dallojmë shumë qartë në pozicionin ambivalent të Shqipërisë. Nga njëra anë, ajo paraqitej si pjesë përbërëse e të ashtuquajturit Komunitet Perandorak Romak, në të cilin, së bashku me Italinë, paraqitej në një status të barabartë dhe parësor. Nga ana tjetër, vetë teoricienët e këtij argumentimi pranojnë se funksionimi i organizimit kushtetues të shtetit shqiptar, pas akteve të kryera në muajt prill-qershor 1939, rezultonte tërësisht i lidhur me ekzistencën dhe funksionin e Partisë Fashiste Shqiptare (PFSH) dhe i ndërlidhur me vendime që merreshin në Romë, e jo në Tiranë. PFSH-ja ishte e lidhur me funksionimin e partisë së saj mëmë, Partisë Fashiste Italiane (PFI), dhe varej vetëm nga urdhrat e Duçes që ishte epiqendra motorike e gjithë aktivitetit shtetëror, përfshirë edhe të Shqipërisë. Pyetja që shtrohet është kjo: Ku qëndron në këto rrethana sovraniteti dhe autonomia e vendimmarrjes së Tiranës së re zyrtare që pretendon Ambrosini në analizën e tij juridiko-kushtetuese?! Të dyja këto tipare të qenësishme të mëvetësisë rezultojnë në fakt të zhdukura. Pozicioni i Shqipërisë është, së paku, në kushtet tipike të një vendi gjysmëkolonial, në të cilin qeveria vendëse ka autoritet të paktë për të ushtruar funksione autonome, ndërsa marrëdhëniet me jashtë, të drejtat

³⁰ *Po aty*, 63.

³¹ *Po aty*, 61-66.

bashkiake rezultojnë të zhdukura tërësisht nën peshën e Ministrisë së Jashtme italiane dhe brenda vendit, të institucioneve ushtarake dhe policore të pushtimit të përhapur anekënd. Madje, pas ndryshimeve gjeopolitike dhe ushtarake në Ballkan, në prill të vitit 1941, kjo panoramë e Shqipërisë së nënshtruar vjen e zgjerohet vetvetiu edhe në “Tokat e Lirume”, me veçorinë atje të një “pranimi realisht të gëzueshëm” nga ana e popullsisë shqiptare që fitoi lirinë nga jugosllavët dhe grekët shtypës. Kjo situatë ruhet pothuajse e paprekur, siç do ta shohim më tej në këtë studim, të paktën deri në mars të vitit 1943, kur pushteti i Musolinit në Romë filloi të tronditej, ndërsa në Shqipëri pasqyrohet me modifikime politiko-administrative, si dhe ndryshime të aktorëve romakë të politikës shqiptare.

Ndër teoricienët që, në atë kohë, u përpoqën të argumentonin në mënyrë shkencore se ky proces unifikues ishte pjesë e udhës së historisë, ishte edhe albanologu i shquar Fulvio Cordignano.³² Përmes një përmbledhjeje koncize të historisë së marrëdhënieve të pandara mes dy brigjeve të Adriatikut, nga Antikiteti deri në bashkëkohësi, atë Cordignano, duke përzier shkencën në funksion të qëllimeve gjeopolitike të regjimit fashist, të cilit tanimë detyrohej t’i shërbente, përpiqet të argumentojë se, duke bashkuar nën emrin e Mbretit fitimtar, fatet e Italisë me ato të Shqipërisë, kësaj të fundit i hapeshin ditë më të mira nën dritën e qytetërimit të Romës.³³ Sipas tij,

“ngjarjet e vitit 1939, kanë çuar në një zgjidhje më natyrale të gjendjes së krijuar që nga Kongresi i Berlinit: por Italia kishte qenë gjithmonë e pranishme në Shqipëri, që nga kohët e vjetra”.

Ndërsa pushtimi i prillit 1939 konsiderohet prej tij si epilogu natyror dhe i nevojshëm i rrjedhave pararendëse të historisë, pasi Italia ishte mbrojtësja e Shqipërisë nga pikëpamja gjeografike, ekonomike dhe kulturore.³⁴

Një avancim të mëtejshëm të këtyre tezave na e paraqet studiuesi tjetër i asaj kohe – një periudhë e mbushur me teoricienë që përpiqeshin të justifikonin agresionet dhe pushtimet – Pio Bondioli, në librin e tij “Shqipëria, Bregu i Pestë i Italisë”.³⁵ Ai shkruan se, me bashkimin me

³² Fulvio Cordignano S.J., *In Albania* (Roma: Società Nazionale Dante Alighieri, 1940).

³³ *Po aty*, 10.

³⁴ *Po aty*, 9.

³⁵ Pio Bondioli, *Albania Quinta Sponda d'Italia* (Milano: C.E.T.I.M., 1939), XVII.

Italinë, Shqipëria nuk kishte zgjidhur vetëm çështjen e kryetarit të shtetit, por edhe atë të jetës së saj të veçantë kombëtare. Sipas tij, as Republika e Fan Nolit, as mbretërimi i Zogut, nuk arritën t'i jepnin Shqipërisë – një vend thellësisht i ndarë në brendësi të saj prej shekujsh dhe i paaftë për të ndërtuar një ekonomi autonome – forcën për t'u ngritur në një nivel qytetërimi dhe mirëqenieje të tillë që ta lejonte të ulej, me barazinë e të drejtave dhe autoritetit, në mesin e familjes së madhe europiane.³⁶ Vetëm Italia, për shkak të pozicionit të saj gjeografik, historisë, përvojës gjatë Luftës së Parë Botërore dhe zhvillimeve pas saj, ishte në gjendje të harmonizonte interesat dhe idealet e saj me interesat jetësorë dhe të ligjshëm të popullit shqiptar, të drejtat e veta për mbizotërim në Adriatik dhe për liri maksimale të lëvizjes e veprimit të plotë në Mesdhe me nevojat më urgjente të një kombi të vogël, por krenar.³⁷ *Për arsye të historisë, gjeografisë, si dhe së drejtës ndërkombëtare dhe shtetërore të periudhës mes Dy Luftërave Botërore*, zgjidhja e adoptuar në prillin e vitit 1939, ishte, sipas Bondioli-t, një pikëmbërritje logjike e premisave të themeluara mbi traditën shumëshekullore të bashkimit të jetës dhe aktivitetit të të dyja vendeve. Nga ana tjetër, 7 prilli, sipas tij, përfaqësonte një pikënisje për të ardhmen – dhe kjo për shkak të asaj që ai e quante: *pamundësi të popullit shqiptar për t'u kyçur në jetën e qytetëruar*. Ai mendonte se, nën sundimin italian, populli shqiptar – i mbetur në prapambetje për shkak të faktorëve të jashtëm, karakterit të vet, dhe mbi të gjitha si pasojë e pushtimit otoman – do të ishte në gjendje të përparonte me shpejtësi drejt nivelit të jetesës europiane, ashtu siç kishin bërë edhe popujt e tjerë ballkanikë.³⁸ Edhe pse vështirësitë në ngjizjen e parimeve themelore qytetëruese qëndronin, arsyetimi historik i Bondioli-t ishte i pavërtetë. Mjafton të kujtojmë se elita qeverisëse italiane, në gusht të vitit 1914, vendosi për copëtimin e Shqipërisë: destabilizoi Mbretërinë e Wied-it, i hoqi përkrahjen, futi në veprim Essad-in, përgatiti Traktatin e Fshehtë të Londrës (26 prill 1915) dhe, deri në vitin 1921, e përdori rastin e këtij vendi me oshilacione qëndrimesh, si një hapësirë për shkëmbime interesash dhe për ruajtjen e balancës së fuqive.

³⁶ *Po aty*, 10.

³⁷ *Po aty*, 12.

³⁸ *Po aty*, 199-201.

Nënsekretari italian i Shtetit për Shqipërinë, Zenone Benini, në numrin e parë të revistës tremujore të Qendrës së Studimeve mbi Shqipërinë, në Romë, botuar në muajin prill 1940, me titullin “*Shqipëria në Perandori*”, shkruan se, pjesëmarrja e Shqipërisë në perandorinë fashiste filloi ditën kur Mbreti Viktor Emanueli III pranoi kurorën e Skënderbeut. Sipas tij, bashkimi i Shqipërisë me Italinë në këtë Bashkësi Perandorake nuk ishte vetëm një akt juridik, por edhe një bashkim shpirtëror dhe moral i popullit shqiptar me atë italian, të mishëruar në figurën e përbashkët të monarkut dhe të Duçes. Qytetarët shqiptarë, pas këtij bashkimi [kupto: pushtim, shënim imi, R. G.] gëzonin, sipas tij, plotësinë e të drejtave civile dhe politike – gjë që në fakt nuk korrespondon të jetë e tillë, e barasvlershme me të drejtat e qytetarëve italianë në territorin e ashtuquajtur perandorak. Nga pikëpamja shtetërore, Shqipëria kishte një figurë juridike qartësisht të individualizuar, pavarësisht se në rregullimin e saj shtetëror reflektonte organizimin politik, shoqëror dhe strukturën e Italisë Perandorake. Sipas tij, Italia nuk synonte të njëjtësonte Shqipërinë, por, përkundrazi, dëshironte ta ringrinte dhe t’i jepte një zhvillim harmonik në çdo fushë këtij vendi.³⁹ Pra, në rastin e Beninit, kemi një përshkallëzim pa maska të tezës së varësisë qytetëruese, duke përfshirë në këtë “mision” edhe kreun e regjimit fashist, Musolinin. Sipas tij, ky i fundit ndërhyr në marrëdhëniet shekullore mes dy brigjeve të Adriatikut në mënyrë krejt të natyrshme, duke e ngritur tanimë nivelin, raportin dhe shkëmbimin ndërkulturor mes dy popujve.

Duke vlerësuar mënyrën se si akademikët dhe politikanët italianë të kohës janë munduar të arsyetojnë dhe të legjitimojnë projektin fashist italian të pushtimit dhe qytetërimit të Shqipërisë, studiuesi Nicola May mendon se studiuesit pro regjimit kanë qenë të përfshirë në tri veprime paralele: 1. ata minimizuan kohezionin kulturor, shoqëror dhe politik të Shqipërisë dhe qëndrueshmërinë e saj si një entitet kombëtar autonom, me qëllim që të justifikonin ndërhyrjen e Italisë; 2. ata theksuan intensitetin historik të marrëdhënieve midis dy popujve që jetojnë në brigjet e detit Adriatik dhe kanë një origjinë të përbashkët etnike, me qëllim që të legjitimonin të drejtën e Italisë për t’u bërë mbrojtësja natyrore e Shqipërisë; 3. u përpoqën të gjenin burimet nga të cilat Shqipëria mund të shihej si një vend që mund të reformohej vetëm

³⁹ ASDMAE, GA, Busta 160, “L’Albania nell’Impero”.

përmes fashizimit dhe Italisë së drejtuar nga Dugja.⁴⁰ Megjithatë, kjo qasje e ndjekur nga autoritetet nuk përputhej me realitetin e deformuar kulturor dhe kombëtar të Shqipërisë, as me realitetin italian, e as me vetë Shqipërinë, referuar historisë paraosmane. Është e vërtetë që midis brigjeve ka pasur marrëdhënie intensive ekonomike, tregtare, kulturore dhe institucionale; megjithatë këto marrëdhënie janë zhvilluar mes popujve të etnive të ndryshme, të cilët ndodheshin paralelisht nën kontrole politike rivale, ose nën nevojën e bashkëpunimit për të përballuar agresione të njëjta. Përrjashtim bënin vetëm zotërimet venedikase dhe kontrolli universal i Papatit përmes institucioneve të kishës dhe misionarëve që ndikuan në mbajtjen gjallë të fisit arbëror gjatë shekujve të errët të okupacionit otoman, kryesisht ndër zonat e brendshme të Shqipërisë, në Veri, por edhe në Jug, ku spikaste Himara.

Bashkimi i Italisë me Shqipërinë dhe, veçanërisht, udhëheqësia e vendit të pushtuar prej urdhrave nga kasta e PFSH-së, është parë nga ideologët e fashizmit dhe argumentuesit e fushës shkencore si shenja e parë historike e rithemelimit të Perandorisë së Romës dhe e lindjes së Bashkësisë Perandorake Fashiste. Megjithatë, pushtimi ishte edhe një veprim tipik imperialist dhe, për rrjedhojë, përveçse shprehje e mbizotërimit territorial dhe tregtar, ishte edhe një përpjekje për të imponuar një qytetërim mbi një popull, i cili ishte penguar dhe ngatërruar në rrugën e vet të njësimin kulturor dhe rikthimit në Europë, për shkak të pushtimit të gjatë otoman dhe ndryshimit të identitetit kulturor arbëror nëpër territorin ku banonin shqiptarët. Sa mund të ndikonte Italia në një dekadë raportesh të ngushta me ish-Mbretin Zog dhe në krejt pak vite në kontrollin e drejtpërdrejtë të Shqipërisë në këtë rikulturizim? Injektimi ka qenë i fuqishëm dhe me pak shembuj në historinë e re të Shqipërisë (kujtoj kohën e zotërimit austro-hungarez të vendit), por i pamjaftueshëm në aspektin kohor për të kryer njëjtësime në një vend që shekujt e pushtimit aziatik e kishin ndarë në pjesë kulturore, krahinore dhe urbane, me kushte të ndryshme zhvillimore dhe prapambetjeje, dhe me vetëdije kombëtare të konceptuar në mënyra të ndryshme dhe ndonjëherë të përkundërta në aspektin identitar. Zonat urbane kanë qenë ato që kanë përfituar më së shumti në aspektin arsimor dhe edukativ nga ndërhyrja

⁴⁰ Nicola Mai, "The cultural construction of Italy in Albania and vice versa: Migration dynamics, strategies of resistance and politics of mutual self-definition across colonialism and post-colonialism", at *Modern Italy*, vol. 8(1) (May 2003): 77-93.

qytetëruese e Italisë, duke lënë mënjanë përpjekjet fashistizuese që kanë qenë formale dhe aspak thelbësore – krejt propagandistike, madje edhe qesharake për njerëzit e zakonshëm të një vendi të përlulur formalisht ndaj pushtimeve të njëpasnjëshme. Po ashtu, ndër krahinat rurale që përfituan më së shumti në pikëpamje të përmirësimit të gjendjes sociale, shëndetësore dhe arsimore, ishin krahinat malore katolike, të cilat përjetuan një lehtësim nga shtypja e pushtetit të bejlerëve, me një mentalitet sundimtar dhe ende otomanist të kryeqytetit, prej dy dekadash jo aq miqësor me ta në pikëpamje të kujdesit të shtetit për qytetarët dhe respektimit të proporcionalitetit të përfaqësimit dhe gëzimit të barabartë të të drejtave të investimeve. Vetë shkollimi i një numri të madh studentësh shqiptarë në Itali ka qenë një ndër masat që ndikoi fuqishëm, fillimisht për “Shqipërinë e Vjetër”, dhe më pas edhe për territoret e reja të bashkuara në shtet, në edukimin me një kulturë të re europiane, e cila deri atëherë hynte në Shqipëri me pikatore. Filizat e kulturës universitare italiane mbetën, jo vetëm në Shqipëri, por edhe në Kosovë dhe shërbyen si bërthamë e kujtesës së kohës së bashkimit me Shqipërinë.

Por, pushtimi ushtarak dhe rregullimi institucional ishte vetëm njëra anë e shtrirjes së Italisë në trevat arbërore. Italianët vepruan edhe përmes investimeve dhe kolonizimit. Propaganda fashiste i paraqiste kolonët që emigronin në territoret e pushtuara si “pionierë” të një epokë të re përparimi, të cilën “Perandoria e Punës” do ta sillte në koloni. Pas pushtimit të Shqipërisë në muajin prill 1939, qeveria e Romës, me përkuljen e qeverisë së Shefqet Verlacit, krijoi mundësinë që rreth 11 000 kolonistë italianë të vendoseshin në Shqipëri, kryesisht në qytetet kryesore të vendit, si: Durrës, Shkodër, Vlorë, Elbasan, Porto Eda (Sarandë). Ata përbënin grupin e parë të të shpërngulurve, kryesisht nga Sicilia dhe Veneto, të cilët do të pasoheshin në vijim nga shumë të tjerë.⁴¹ Pjesa më e madhe e kolonistëve të parë të vitit 1939 u inkuadruan në grupet paraushtarake shqiptare të “Këmishëve të Zeza”, që gradualisht u organizuan në katër legjione me shtab qendror në Tiranë dhe degët në Shkodër, Korçë dhe Vlorë. Pas tyre, pasuan edhe 22 000 punëtorë krahu që u sollën në Shqipëri për ndërtimin e rrugëve dhe infrastrukturës në prill 1940, në kohën kur Italia po përgatitej për invadimin e padrejtë të Greqisë nga toka e Shqipërisë.

⁴¹ Richard Lamb, *Mussolini as Diplomat. The changing Alliances of Italy* (Lume Books: 2017), 142.

Në fund të pushtimit, numri i ndërmarrjeve italiane në Shqipëri arriti rreth 300. Numri i profesionistëve dhe i nëpunësve që depërtuan në çdo sektor të jetës shqiptare ishte disa mijëra. Kuotën më të lartë, punonjësit italianë në Shqipëri e arritën në kohën e Luftës Italo-Greke, kur punëtorët, në një masë të madhe të inkuadruar në centurie, llogariteshin në 58 000, ndërsa numri i civilëve të tjerë arriti në 12 000.⁴²

George Rochat, historian italian i specializuar në historinë ushtarake, mendon se kolonializmi italian ishte i ngopur me racizëm dhe abuzim pushteti, pasi ideja kryesore e tij për të imponuar dëshirën e një njeriu fatit të një populli, ushtarakisht më të dobët, është një ide dhe projekt thellësisht racist dhe shtypës.⁴³ Pavarësisht se projekti kolonizues i Musolinit synonte ta shndërronte tokën shqiptare në një tokë italiane – përmes dhënies së pronave edhe për të ngulurit e rinj, lehtësirave ligjore etj., mund të themi se, jo vetëm për kohën e shkurtër në dispozicion dhe disfatën katastrofale që pësuan italianët në Shqipëri me ardhjen e gjermanëve, por edhe për arsye të një realiteti social dhe kulturor të ndryshëm, si dhe skemave nacionaliste të establishmentit shqiptar, të Italisë në Tiranë, ky projekt do të ishte i paarritshëm dhe krejtësisht jashtë realitetit dhe mundësive që ofronte terreni vendës. Pavarësisht se pushtuesit italianë mendonin fillimisht se populli shqiptar nuk do të ishte në gjendje të mbronte lavdinë dhe krenarinë e vet, dhe se do të neutralizohej nga prosperiteti ekonomik që do të sillte pushtimi dhe kolonizimi, në planin praktik, me kalimin e viteve ata kuptuan se aspirata për një shtet kombëtar në trojet etnike dhe për një liri pa praninë e një ushtrie të huaj ishte thellësisht e rrënjosur dhe vendimtare në vetëdijen e shqiptarëve të thjeshtë. Thënë ndryshe, midis miteve dhe dogmave shpëtuese të përhapura nga propaganda fashiste në njërën anë, dhe realitetit faktik në Shqipërinë e varfër, në anën tjetër, ekzistonte një hendek i madh, kapërcimi i të cilit kërkonte arsyetim dhe realizëm në administrim, gjë që klasa udhëheqëse fashiste në këtë kohë harbimi dhe kapërthimit nga paranoja nuk e kishte.

Udhëheqësia shqiptare proitaliane është përpjekur të operojë me një skemë dyfaqëshe: në faqen e parë të komunikimit të saj publik, ajo, njëlloj si teoricienët e fashizmit, iu përmbajt linjave zyrtare të

⁴² Leone G. B. Nigris, "Delegato Apostolico, Cenni sulle vicende dell'Albania dal 1938 al 1944", 01.01.1945, f. 52, në *Archivio della Segreteria di Stato*, Vaticano, Affari Straordinari, Albania 57, Prot. 2567/45, Delegazione Apostolica in Albania.

⁴³ Gorgio Rochat, *Il Colonialismo italiano* (Torino: Loescher Editore, 1973), 222.

argumentimit të qenies së Shqipërisë nën suazën e Bashkësisë Perandorake të Romës dhe së “ardhmes së ndritur” nën këtë mbrojtje të epërme të një shteti më të fuqishëm. Faqja e dytë e ligjërimeve të saj kalon në një plan më konkret dhe më të arsyeshëm argumentimi, që lidhet me nevojën shqiptare për zhvillim dhe shkëputje nga Mesjeta e ngurtësuar në trevat e veta; për zhvillim infrastrukturor, arsimor, kulturor dhe për modernizim administrativ. Mbi të gjitha, arsyeja e saj funksiononte në ndihmën e Italisë për rikthimin e Shqipërisë në konturet normale kombëtare, d.m.th. në riformatimin territorial të shtetit në të gjitha trojet etnike. E gjejmë këtë strukturim të ligjëritimit te fjalimet e udhëheqësve kryesorë politikë, si: Mustafa Kruja, Ernest Koliqi, Terenc Toçi etj., deri tek editorialet e gazetave “Fashizmi” dhe “Tomori”, në mënyrë të ripërsëritur. Për t’u përmendur në këtë trajtim mbetet fjalimi i kryetarit të Këshillit të Epërm Fashist, Terenc Toçi, në Milano, në muajin maj 1942, i titulluar, “Idea Perandorake e Shqipërisë”.⁴⁴ Teza e tij themelore përmbledhej kështu:

“Kombi Shqiptar, i fatkequr si asnjë tjetër gjatë mijëra vjetve të historisë së vet të trazuar, për të parën herë në Europë, e pati fort të mprehtë ndiesinë dhe parandjenjën gjeniale për të kuptuar, se grupet e vegjël etnikë, në qoftë se duan të rojnë një jetë të tyren me vehte, në paqe e në siguri, duhet të mbështeten në një njësi të madhe kombëtare e politike”.⁴⁵

Toçi thekson gjithashtu kuptimin dhe parimin mbi të cilin mbështetet Komuniteti Perandorak për Shqipërinë: *një bashkëpunim i ngushtë ndërmjet popujve të ndryshëm, në barazi të plotë politike dhe pa paragjykime në veprimin drejtues e koordinues të nuklit qendror të komunitetit*.⁴⁶ Të famshme mbetën po ashtu, fjalimet e senatorit Kruja në Akademinë Mbretërore të Italisë (“Karakteret natyrore dhe historike të Shqipërisë së Madhe”⁴⁷), fjalimi programor për qeverinë që ai mori përsipër ta drejtonte në dhjetor 1941 (“Politikë energjike dhe e qartë për arritjen e qëllimeve në kuadrin e Komunitetit Perandorak”, që ishte e strukturuar në këto çështje: Heroizma italo-shqiptare, Rendi i Ri, Vllaznia e dy popujve, Ndërgjegjja e njësisë kombëtare⁴⁸), ligjërata e tij

⁴⁴ Gazeta *Tomori*, Tiranë, 13, 14 dhe 16 maj 1943, "Idea Perandorake e Shqipërisë".

⁴⁵ *Po aty*, 13 maj 1943, Terenc Toçi, "Idea Perandorake e Shqipërisë".

⁴⁶ *Po aty*, 16 maj 1943, Terenc Toçi, "Idea Perandorake e Shqipërisë".

⁴⁷ *Po aty*, 11 qershor 1941, viti XIX.

⁴⁸ *Po aty*, 11 dhjetor 1941, viti XIX, nr. 303.

në Campidoglio më 19 shkurt 1942 e titulluar “Shqipnija në luftë për Rendin e Ri”⁴⁹ dhe fjalimi i fundit si kryeministër më 23 nëntor 1942, i titulluar “Në Hulli të Historisë”, ku Kruja përpiqet të justifikojë me një retorikë nacionaliste, dështimin e politikës italiane mbi Shqipërinë pas implikimit të pakthyeshëm të qeverisë vendore në luftë kundër aleatëve perëndimorë.⁵⁰ Fjalimi i tij, së bashku me atë të Ernest Koliqit, me rastin e marrjes së kryesimit të Këshillit të Epërm Korporativ Fashist, është i mbushur me kritika ndaj deklaratave të Eden-it dhe Cordell Hull-it për pavarësinë dhe kufijtë e Shqipërisë – deklarata që, në fakt, hidhnin poshtë dhe nuk njihnin “Shqipërinë e Madhe” të krijuar nga fuqitë qendrore. Këto dy fjalime (të dëshpëruara, për shkak se konceptuesit shihnin rrugën e tyre për Shqipërinë të fundosur), mund të konsiderohen si lajmëtarët e para të dështimit të politikës italiane mbi Shqipërinë dhe si sinjal paralajmërues i hapave prapa që do të pësonte shteti shqiptar, territorialisht, në rast të humbjes finale të Italisë.⁵¹ Dy njerëz të ditur shohin jo vetëm veten e tyre politikisht në një qark të mbyllur, por edhe fatin e Shqipërisë të orientuar drejt një rruge rindërtimi – aq shumë të aspiruar kombëtarisht, por po aq tragjikisht, drejt një thyerjeje të re dhe një tuneli të errët. Pikërisht këtu, me këto deklarata, nis kthesa e madhe përkundër projektit perandorak: pendimi, vlerësimi i qëndrimeve të tyre me realizëm, ashtu siç nis edhe njohja e luftës së gjysmës së popullit shqiptar kundër okupatorit fashist. Ky është rasti i atyre pak politikanëve shqiptarë që ditën të reflektonin mbi dështimet e projekteve të tyre ideale, mbi shpresat e tyre të humbura dhe mbi kontributet e fishkura nga forca madhore të kontrolluara gjatë.

Epilogu i pushtimit italian të Shqipërisë

Përpjekja fashiste italiane ka ruajtur komponentët e vet ndikues mbi propagandën perandorake fashiste, sikurse ishte programuar nga establishmenti i Romës në fillësë, deri në fund të vitit 1942, mbase edhe në muajt e parë të vitit 1943. Zhvillimet e brendshme në Itali dhe në Shqipëri, si dhe situata ndërkombëtare e pafavorshme për vendet e Boshtit në rrjedhën e vitit 1943, ndikuan në rimodelimin e qëndrimit imperialist dhe fashistizues të establishmentit të Romës, pas rënies së

⁴⁹ *Po aty*, 20 shkurt 1942, viti XX, nr. 44.

⁵⁰ *Po aty*, 24 nëndor 1942, viti XXI nr. 281.

⁵¹ *Po aty*, 24 dhjetor 1942, Viti XXI, “Ligjërata e ndritun e Ernest Koliqit”.

qeverisë së Mustafa Krujës. Qeveritë që erdhën më pas, veçanërisht pas largimit të Mëkëmbësit Jakomoni dhe ardhjes së Parianit, institucionalizimit të Komisionit të Përzier për Koordinimin e Marrëdhënieve me Jashtë të të dyja vendeve dhe shkëmbimit të delegatëve qeveritarë në Tiranë dhe Romë, filluan zhveshjen e institucioneve fashiste dhe rindërtimin formal dhe material të institucioneve vendëse, me varësi më të madhe në çështjet civile nga Tirana qeveritare. Pariani, madje edhe në mesazhin e mbërritjes në Shqipëri, megjithëse vazhdonte të përmendte Mbretin – Perandor, fliste paralelisht për *“reforma politike që siguronin pavarësinë dhe sovranitetin e Shqipërisë”*, si edhe *“për mirëqenien e Shqipërisë Kombëtare dhe të pavarur”* etj.⁵² Këto përbënin sinjale të qarta të një politike të re që po përvijohet në Romë, e diktuar nga rrethanat dhe skemat e reja të udhëheqësisë që po skicoheshin në prapaskenë. Ishte koha kur jo vetëm establishmenti romak, por edhe ai vendës i Tiranës filloi të hynte në krizë, pasiguri dhe paqartësi lidhur me të ardhmen. Klasa e kolaboracionistëve nisi të kuptonte se përjetësia e perandorisë dhe e Duçes në “Bregun e Pestë” kishte qenë jo vetëm e përkohshme dhe e pamundur, por edhe se pushteti që ata krijuan në këtë vend të vogël ballkanik ishte një sipërmarrje tërësisht e shkëputur nga realiteti dhe përditshmëria e shoqërisë shqiptare – një ideologji krejtësisht abstrakte dhe utopike, e paaftë të përthithej kulturalisht, që promovonte dhunën, shfrytëzimin dhe përdorimin, ndërkohë që përfitimi fillestar ekonomik dhe arsimor do të rrënohej me përshtetshmërinë e luftës. Nga kjo kohë, fillimisht flitet për interesa të përbashkët mes Shqipërisë dhe Italisë pa përmendur më perandorinë; flitet për “frymë të re”, që vjen me qeverinë e Maliq Beg Bushatit, për “baza të reja mbas marrëveshjeve me Italinë”,⁵³ por gjithnjë e më rrallë deri në shuarje të plotë, ceket çështja e Bashkësisë Perandorake të Romës, që zhduket nga ligjërimi publik paralelisht me dezintegrimin/fikjen e establishmentit fashist të Musolinit, me ardhjen në pushtet të Badoglio-s. Në kohën e qeverisë së Ekrem Libohovës, Italia dhe Shqipëria përpiqeshin të dukeshin si dy shtete të pavarura, të cilat shkëmbejnë delegatët diplomatikë dhe kishin ushtri dhe xhandarmëri të veçanta. Ajo që mbante të gjallë entuziazmin e shqiptarëve në këtë kohë

⁵² *Po aty*, 18 mars 1943, viti XXI, “Mesazh drejtuar popullit shqiptar”.

⁵³ *Po aty*, 18 frur 1943, viti XXI, “Udhëzimet politike të Qeverisë së ré i u paraqiten Kombit nga Kryeministri Shkëlq. Bushati”.

degradimi dhe lufte të brendshme vëllavrasëse në Shqipërinë e Vjetër ishte shpresa e Kosovës, Dibrës, Tetovës, Strugës, Malësisë dhe Ulqinit për të qenë edhe më tutje në Shqipëri. Kjo ishte vepra më e mirë e realizuar nga perspektiva e qarqeve nacionaliste dhe tradicionaliste, të cilat u vunë në shënjestër nga internacionalistët komunistë që vareshin nga PKJ-ja. Shqiptarët e “Tokave të Lirue” të cilët kishin vuajtur për rreth 30 vjet nga shtypja, shkombëtarizimi, deportimet dhe shpërnguljet e sforcuara, si dhe nga invadimi i forcave ushtarake italiane dhe gjermane, e përjetuan rivendosjen e autoritetit shtetëror të Tiranës nën Italinë, si një çlirim, liri dhe si fillimin e një epoke të re që punonte në dobi të interesave kombëtarë shqiptarë, përkundër shovinizmit jugosllav. Qëndrimi ndaj “Tokave të Lirue” do të hyjë si një element i ri përçarës dhe çoroditës në pozicionimin strategjik të shqiptarëve në konfliktin botëror. Ndodhi, pra, që fuqitë fashiste të Boshtit Qendror, për synimet e tyre strategjike të kontrollit të Europës Juglindore, krijuan të ashtuquajturën “Shqipërinë e Madhe”, e cila, në fakt, ishte diçka më pak se Shqipëria reale. Megjithatë, përmes këtij procesi, ato tërhoqën pas masivisht, popullsinë e viseve të reja në shtet, patriotët në të gjithë Shqipërinë, si dhe shtresa të gjera të popullsisë. Ndërkohë, nga ana tjetër, Aleatët antifashistë, së paku nga fundi i vitit 1942, do të shprehnin mbështetjen për njohjen e independencës së Shqipërisë në kufijtë e vitit 1939. Kjo nënkuptonte se ndryshimet kufitare të realizuara nga Berlioni dhe Roma nuk do të njiheshin pas përfundimit të luftës.

Përfundime

Bashkësia Perandorake e Romës nën udhëheqjen e Musolinit dhe genia e Shqipërisë brenda kësaj bashkësie do të mbeteshin një projekt jorealit, i shkëputur nga binarët e ngjizjes nën një strukturë të përbashkët shtetërore dhe nën një udhëheqësi politike për dy popuj e dy entitete shtetërore, me thelbe kulturore të ndryshme, me zhvillime historike të ndërprera nga ndërhyrja e rrënjosur në gëmin social e pushtimit otoman pesëshkullor, si dhe me një gjendje ekonomike sociale krejtësisht të pabarabartë. Pavarësisht udhëve historike që herë pas here kryqëzoheshin dhe përpjekjeve prej dekadash të establishmentit politik italian për të depërtuar në Shqipëri, ndjesia e popullit shqiptar për të qenë pjesë e së njëjtës çati perandorake ishte formale, e përkohshme, e përlulur prej hallit dhe pa bindje të vërtetë. Kjo, pavarësisht propagandës së elitës politike

dhe kulturore, e cila, në fakt, as vetë nuk besonte në jetëgjatësinë e projektit jorealit të Musolinit dhe kontit Çiano.

Në qoftë se elita politike në Itali e ka parë ekspansionin – le ta quajmë kolonial dhe imperialist – të Italisë në bregun lindor të Adriatikut si një mundësi për të lehtësuar çështjen e punësimit, zbutjen e diferencave ekonomike të Italisë së Jugut, përmes emigrimit të mijëra krahëve të lirë, elita shqiptare – kryesisht ajo e biznesit – e ka vlerësuar këtë aventurë të fashizmit në Shqipëri si një rast për përfitime të brendshme dhe individuale: për pasurim, prosperitet, shkollim të fëmijëve dhe zgjerim të tregut kombëtar, të paktën në hapësirën kombëtare shqiptare në Ballkan. Dhe në fakt, ky proces i dytë ndodhi me shpejtësi, pasi një komb i etur për bashkim shfrytëzoi menjëherë rastin që i ofroi një “aksident historik”, pa u shqetësuar se kush e kishte bërë të mundur atë.

Imagjinata kombëtare e kolonëve italianë që u vendosën në Shqipëri u lidh dhe farkëtua formalisht me idenë e racës, përkatësisë kombëtare me kryeqendrën metropolitane të perandorisë, si dhe me ndjenjën e superioritetit të të drejtave civile dhe politike – këto të fundit të ndërlidhura ngushtësisht me angazhimin e tyre pothuajse në bllok në aradhet e organizatës fashiste. Mirëpo kjo mbivendosje e tyre në shoqërinë shqiptare, mbeti formale, e përkohshme dhe ka luajtur, sipas asaj çfarë kuptojmë ne, një rol simbolik në imazhin perandorak romak në vendin ballkanik. Dhe nuk mund të ndodhte ndryshe, përderisa ky imazh nuk kishte depërtuar aq bindshëm as në shoqërinë italiane të kohës.

Vetë perandoria e themeluar artificialisht nga elita fashiste e Romës do të pësonte një kolaps të shpejtë gjatë vitit 1943, duke shembur jo vetëm retorikën e regjimit, por edhe të gjithë strukturën e pushtetit të ndërtuar me aq madhështi nga Musolini. I vetmi element që i mbijetoi rënies së regjimit fashist në Shqipëri ishte Shqipëria natyrale, të cilën gjermanët e ruajtën sikurse e kishin ndërtuar në vitin 1941.

Kësisoj mund të themi se Perandoria Romake e zgjeruar në Shqipëri, më shumë se një realitet institucional, politik, ekonomik dhe kulturor, ishte një imagjinim historik, një mit që nuk i mbijetoi kohës së përmbysjeve të shpejta të Luftës së Dytë Botërore. Kjo përpjekje për të implantuar një regjim artificial në Shqipëri, përfshirja në një masë të madhe e shtresave të gjera të klasave të mesme dhe të larta të vendit në këtë sipërmarrje imagjinare, shkaktoi një katastrofë në pikëpamje të udhëheqësisë në vendin e vogël ballkanik, që vështirësisht ishte formuar

disa dekada më parë si shtet independent. Implikimi formal i elitës në bashkëpunimin me regjimin perandorak romak, të vendosur në mënyrë artificiale në Shqipëri, do të përbënte një llogarimbajtje për "ushtarët e kuq" që zbankuan në qytetet e Shqipërisë në nëntorin e vitit 1944, të cilët me forcën e armëve do të shuanin çdo shpresë për një rimarrje të kulturuar dhe demokratike të vendit pas Luftës së Dytë Botërore, si dhe për mbrojtjen e kufijve kombëtarë të formësuar në vitin 1941.

Burime e bibliografi:

Burime arkivore:

Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (AQSH)
Fondi Mëkëmbësia e Përgjithshme

The National Archives, London (TNA)
Public Record Office (PRO), Fondet e Foreign Office (FO)

Archivio Storico Diplomatico, Ministero degli Affari Esteri, Roma
(ASDMAE)
Fondi Gabinetto Albania

Botime dokumentare:

Foreign Relations of United States, Diplomatic Papers, 1939, Volume II, (Gen. ed.) G. B. Noble, E.R. Perkins, (Editors) M. Axton, R. Churchill, F. C. Prescott, J. G. Reid etc. Washington: United States Government Printing Office, 1956. (University of Wisconsin – Medison Library <https://digital.library.wisc.edu>)

Literaturë:

BASCIANI, Alberto. *L'impero dei Balcani, L'occupazione italiana dell'Albania (1939-1943)*. Roma: Viella, 2022.

BONDIOLI, Pio. *Albania Quinta Sponda d'Italia*. Milano: C.E.T.I.M., 1939.

BOSWORTH, R. J. B. *Mussolini's Italy. Life under the Dictatorship 1915-1945*. Penguin Books: 2006.

CORDIGNANO, S.J. Fulvo. *In Albania*. Roma: Società Nazionale Dante Alighieri, 1940.

- GASPARE, Ambrosini, *L'Albania nella comunità imperiale di Roma*, Quaderni dell' Instituto Nazionale di Cultura Fascista, Serie Decima. Roma: N. V -1940.
- KNOX, Macgregor. *Mussolini Unleashed 1939-1941, Politics and Strategy in Fascist Italy's Last War*. Cambridge University Press, 1982.
- LAMB, Richard. *Mussolini as Diplomat. The changing Alliances of Italy*. Lume Books: 2017.
- MAI, Nicola. "The cultural construction of Italy in Albania and vice versa: Migration dynamics, strategies of resistance and politics of mutual self-definition across colonialism and post-colonialism", *Modern Italy*, vol. 8(1) (May 2003): 77-93.
- MASON, Henry L. *The purge of Dutch Quislings, Emergency Justice in the Netherlands*. The Hague: Martinus Nijhoff, 1952.
- MAZOWER, Mark. *Dark Continent, Europe's Twentieth Century*. Penguin Books: 1999.
- NIGRIS, Leone G.B. "Delegato Apostolico, Cenni sulle vicende dell'Albania dal 1938 al 1944", 01.01.1945, f. 52. Në: Archivio Della Segreteria Di Stato, Vaticano, Affari Straordinari, Albania 57, Prot. 2567/45, Delegazione Apostolica in Albania.
- ROCHAT, Gorgio. *Il Colonialismo italiano*. Torino: Loescher Editore, 1973.
- RODOGNO, Davide. *Il Nuovo Ordine Mediterraneo. Le politiche di occupazione dell'Italia fascista in Europa (1940-1943)*. Torino: Bollati Boringhieri, 2014.
- STAJKA, N.P. & B.D Marku, Z.A. Martini. *Në sofër pa pastashutë e pa bistekë*. Assisi: 1961.
- VILLARI, Giovanni. "A Failed Experiment: The Exportation of Fascism to Albania", at *Modern Italy*, vol. 12, no. 2 (June 2007).

Shtypi:

Gazeta *Tomori*, Tiranë, 1941-1943.

Prof. dr. ROMEO GURAKUQI

Institute of History / Academy of Sciences of Albania

romeo_gurakuqi@hotmail.com

romeo.gurakuqi@asa.edu.al

S u m m a r y

ALBANIA IN THE ROMAN IMPERIAL COMMUNITY

1939–1943

(THE CONSTITUTIONAL SOLUTION TO THE RELATIONSHIP
BETWEEN ALBANIA AND ITALY)

The article studies Albania's political and institutional history during its occupation by Fascist Italy from 1939 to 1943. The author examines phenomena that historiography typically classifies as post-capitulation phenomena, which were present in all countries occupied by fascist armies. The study explains how the fascist regime in Albania established a state structure that was totalitarian in terms of information control and secret police operations, while in its broader control of society, it can be considered authoritarian.

For the first time in Albanian historiography, the author proposes a cyclical division of the phases through which the Italian fascist occupation of Albania progressed. A significant portion of the study is dedicated to analysing Albania's role within the Roman Imperial Community, the Imperial Scheme of the Subjugated Living Space, the degree of autonomy granted to the Albanian authorities of the puppet government within the Empire, and the status of the Kingdom of Albania about the broader imperial framework, particularly in comparison to the Kingdom of Italy and Ethiopia.

The author argues that the expansion of the Roman Fascist Empire into Albania was more than an institutional, political, economic, or cultural reality, a historical imagination—a myth that could not withstand the rapid upheavals of World War II. This attempt to implant an artificial regime in Albania and the deep involvement of large segments of the country's middle and upper classes in this imaginary enterprise led to a leadership crisis in the tiny Balkan nation. This crisis proved catastrophic for a state that had only recently emerged as an independent entity just a few decades earlier.

Key words: Fascist Italy, Invasion of Albania, Post-Capitulation, Fascist Roman Empire, Personal Union of the Crowns, Italian Colonialism.